



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Nr _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2020

SHTOJCË

PËR NDRYSHIMIN E DATËS SË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është duke ndjekur me shqetësim situatën e krijuar për shkak të përhapjes së koronavirusit COVID-19 i cili ka prekur edhe Shqipërinë. Gjithashtu me anë të Vendimit nr. 243 datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatëkeqësisë natyrore” është shpallur gjendja e fatëkeqësisë natyrore. Në nivel ndërkombëtar, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shpallur gjendjen e pandemisë.

Planet e masave të marra në Republikën e Shqipërisë si edhe në shumë shtete për ndalimin e përhapjes së virusit kanë ndikuar në shumë sektorë të ekonomisë. Autoriteti kontraktues me synim nxitjen e konkurrencës mbështetur në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, vlerëson nevojën e shtyrjes së afatit të dorëzimit të ofertave të procedurës së koncesionit / partneritetit publik privat, me objekt “Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit të Vlorës” me Nr. Reference REF-46571-12-19-2019, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

Kjo masë ndërmerret në mbrojtje të interesit më të lartë publik, si edhe në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

Sa më sipër:

IV.3. Afati kohor për dorëzimin e ofertave:

ISHTE:

Brenda dhe jo me vonë se:

Data: 30/03/2020 Ora: 13:00

Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

BËHET:

Brenda dhe jo me vonë se:

Data: 21/04/2020 Ora: 13:00

Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave:**ISHTE:**

Brenda dhe jo me vonë se:

Data: 30/03/2020 Ora: 13:00

Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

BËHET:

Brenda dhe jo me vonë se:

Data: 21/04/2020 Ora: 13:00

Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT